



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS



**BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES
SË KONSUMATORIT**

Nr. 1486 Prot, datë 27.5 2025

Nr. _____ Prot, datë _____ 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

(FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE)

DHE

AGJENCISË SË MBROJTJES SË KONSUMATORIT

**“PËR PRAKTIKAT PROFESIONALE TË STUDENTËVE NË STREHËN
VETERINARE TË KAFSHËT ENDACAKE.**

E lidhur sot në datën 27.5 2025, nëpërmjet palëve, si më poshtë:

Universitetit Bujqësor të Tiranës, me adresë: Rruga Paisi Vodica Kodër Kamëz, Tiranë,
përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Fatbardh Sallaku,

dhe

Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, me adresë: Rruga “Murat Toptani”, Tiranë,
përfaqësuar nga Titullari i Institucionit, Znj. Blerta Dardha.

Palët në këtë marrëveshje do të bashkëpunojnë përmes strukturave të tyre kompetente,
përkatësisht për Universitetin Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare dhe Agjencia

e Mbrojtjes së Konsumatorit, për Praktikën Profesionale të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare pranë Strehës Veterinare të kafshëve endacake.

Palët në këtë marrëveshje bien dakort si më poshtë:

NENI 1

OBJEKTI I MARRËVESHJES

Me anë të kësaj marrëveshjeje, palët bien dakord që studentët Universitetit Bujqësor të Tiranës, pranë Fakultetit të Mjekësisë Veterinare të kryejnë praktikën profesionale pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, me qëllim përvetësimin e njohurive praktike, zhvillimin e aftësive profesionale dhe kontributin në realizimin e misionit për mirëqenien e kafshëve në Strehën Veterinare të kafshëve endacake.

NENI 2

BAZA LIGJORE

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 10, datë 12.10. 2011 “Për krijimin e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë” Ligji Nr 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 475 datë 30.07.2021, “Për Bashkëpunimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore me Shërbimin Veterinar”, Statutin e UBT-së të miratuar me Urdhrin nr. 586, datë 02.12.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare me nr. 238/2 prot., datë 20.12.2021, neni 26 “Organizimi i Praktikave Profesionale”

NENI 3

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E FAKULTETIT TË MJEKËSISË VETERINARE

1. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare në Universitetin Bujqësor të Tiranës angazhohet të dërgojë studentët për zhvillimin e praktikave profesionale, në përputhje me procedurat dhe aktet rregullative në fuqi.
2. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare njofton Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit, lidhur me numrin e studentëve, afatet kohore për kryerjen e praktikave profesionale, trajtimin e rrjetit të vullnetarëve, dhe organizimin e rrjetit të vullnetarëve për përfshirjen në veprimtari praktike.

3. Vendos në dispozicion punonjësit që merren me koordinimin e procesit, zgjidhjen e paqartësive dhe komunikimin ndërinstitucional gjatë zhvillimit të praktikës.
4. Studentët do të kryejnë praktikën sipas protokolleve veterinarë për kontrollin e sëmundjeve zoonotike në përputhje me ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, neni 54, VKM nr. 475 datë 30.07.2021, “Për Bashkëpunimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore me Shërbimin Veterinar”, si dhe akteve të tjera të zbatueshme në fushën e shërbimit veterinar
5. Palët angazhohen të zgjerojnë bashkëpunimin ndërmjet kapaciteteve të tyre njerëzore, me synim shkëmbimin e eksperiencave në fushat e Kirurgjisë, Radiologjisë, Ekografisë dhe Propedeutikës, si dhe për adresimin dhe menaxhimin e problematikave emergjente që mund të paraqiten gjatë zhvillimit të praktikës.
6. Palët angazhohen të organizojnë trajnime të përbashkëta në fusha me interes të ndërsjellë, të cilat do të zhvillohen në mjediset e Fakultetit të Mjekësisë Veterinarë.
7. Fakulteti angazhohet të sigurojë mbikëqyrje akademike dhe vlerësim të studentëve për periudhën e praktikës, si dhe të përcaktojë një koordinator përgjegjës për ndjekjen e ecurisë së praktikës në bashkëpunim me AMK.
8. Fakulteti angazhohet të informojë dhe të udhëzojë studentët që, përpara fillimit të praktikës, të jenë të pajisur me sigurim shëndetësor dhe/ose sigurim ndaj aksidenteve, të cilin e përballojnë vetë.
9. Fakulteti garanton që studentët të kenë përfunduar **trajnimin paraprak mbi etikën veterinarë dhe trajtimin human të kafshëve**.
10. Fakulteti mban përgjegjësi për orientimin teorik dhe mbikëqyrjen akademike.

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AGJENCISË SË MBROJTJES SË KONSUMATORIT

1. Në përputhje me kapacitetet e saj, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit do të pranojë studentët e Fakultetit të Mjekësisë Veterinarë për Praktika Profesionale, duke vendosur në dispozicionin e tyre stafin mjekësor veterinar si dhe ambientet e laboratorit, kirurgjisë për ndjekjen e procedurave praktike, përfshirë trajtimet bazë dhe ndërhyrjet mbikëqyrëse sipas standardeve veterinarë.
2. Palët do të bashkëpunojnë përmes specialistëve të tyre në vlerësimin dhe monitorimin e situatës epizootike, duke shkëmbyer përvojë dhe ekspertizë në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve infektive dhe parazitare të konfirmuara brenda territorit të Bashkisë Tiranë.
3. Studentët do të paraqiten në Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit me dokumentin i cili jepet nga Dekanati apo përfaqësuesi i Fakultetit të Mjekësisë Veterinarë, i autorizuar.
4. Studentët do të trajnohen sipas protokolleve të përcaktuara në rregulloren e brendshme të qendrës veterinarë, përfshirë procedurat për sterilizim, vaksinim, trajtime antiparazitare dhe çdo trajtim tjetër të nevojshëm, në varësi të rastit konkret.

5. Studentët do të jenë nën mbështetjen e vazhdueshme të stafit mjekësor veterinar të AMK-së, me qëllim krijimin e mundësive dhe lehtësive të nevojshme, për zhvillimin e praktikave profesionale.
6. Midis strukturave do të zhvillohet bashkëpunim edhe për trajnime të ndërsjella lidhur me mënyrën e trajtimit të qenve, ndërhyrjet specifike veterinare dhe përmirësimin e standardeve të kujdesit ndaj kafshëve në strehë.
7. Secila nga palët angazhohet të caktojë dhe miratojë zyrtarisht një koordinator përgjegjës për ndjekjen dhe koordinimin e praktikës profesionale, në kuadër të kësaj marrëveshjeje.
8. AMK angazhohet të respektojë normat e etikës dhe sigurisë në punë, të pajisë studentët me mjetet mbrojtëse dhe të sigurojë një ambient profesional në përputhje me standardet veterinare.

NENI 5

PËRGJEGJËSITË LIGJORE DHE ETIKE

1. Para fillimit të praktikës, studentët duhet të jenë të pajisur me sigurim shëndetësor dhe/ose sigurim ndaj aksidenteve.
2. Në rast incidentesh apo aksidenti gjatë kryerjes së praktikës, palët bashkëpunojnë për hetimin, raportimin dhe menaxhimin e rastit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
3. Studentët trajnohen paraprakisht mbi **masat e sigurisë, protokollet veterinare dhe trajtimin human të kafshëve**, si pjesë e programit të praktikës.

NENI 6

PERSONAT E KONTAKTIT

Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe në formë zyrtare. Në çastin e nënshkrimit të kësaj akt marrëveshjeje personat e kontaktit janë si më poshtë:

1. **Personat e kontaktit për Universitetin:** Dekani i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, Prof. Dr. Rezart Postoli me adresë email-i: rezart.postoli@ubt.edu.al
 2. **Personat e kontaktit për AMK-në:** _____
-

NENI 7

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi, hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga palët përkatëse.
2. Palët bien dakord që çdo student të nënshkruajë një deklaratë etike dhe informimi për rreziqet, përpara fillimit të praktikës.
3. Kjo marrëveshje nënshkruhet për një periudhë kohe 3 vjeçare nga data e nënshkrimit.
4. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve bëhet me mirëkuptim midis palëve, me njoftim të paktën 30 ditë përpara, me shkrim dhe me arsye të argumentuar.
5. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të pësojë ndryshime vetëm me **akt shitesë** të miratuar nga të dyja palët. Një ndryshim i tillë do të zbatohet për aktivitetet në zbatim, përveç se nëse është rënë dakord ndryshe nga Palët.
6. Për zbatimin e kësaj marrëveshje ngarkohen Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Kjo Marrëveshje mbahet në 4 (katër) kopje autentike, dhe nënshkruhet nga palët.

**UNIVERSITETIT BUJQËSOR I
TIRANËS**

REKTORI

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU



**AGJENCIA E MBROJTJES SË
KONSUMATORIT**

Drejtore i Përgjithshëm

Znj. Blerta DARDHA